



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MBROJTJES



**23-29** MARS

**JAVA E MBROJTJES**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MBROJTJES

# “DITË E HAPUR” NË KUÇOVË E ROGOZHINË

Në kuadër të fushatës rekrutuese për ushtarë, detarë dhe ajrorë aktivë, Forcat e Armatosura të Shqipërisë zhvilluan aktivitetin “Ditë e Hapur” në Rogozhinë dhe Kuçovë. Të rinjtë patën mundësinë të njihen nga afër me misionin, rolin dhe sfidat e shërbimit në uniformë, si dhe me rrugët që ofron kjo karrierë për zhvillim personal dhe profesional. Një mundësi për t’u informuar, për t’u frymëzuar dhe për të hedhur hapin drejt një të ardhmeje me përgjegjësi dhe krenari.






# OPERACION EOD NË TIRANË, DURRËS DHE ELBASAN

Operacionet për vlerësimin dhe largimin e municioneve të paplasura në bashkitë Tiranë, Durrës dhe Elbasan kanë përfunduar me sukses. Municionet e identifikuara janë ekzaminuar nga operatorët EOD në përputhje me procedurat përkatëse, duke u klasifikuar si të sigurta për të vijuar më pas me transportimin dhe magazinimin e tyre në ambientet e përcaktuara.

★★★★★



## AFA PJESË E “EMILYO”

Për herë të parë, Akademia e Forcave të Armatosura bëhet pjesë e iniciativës së akademike ushtarake të Bashkimit Evropian “EMILYO”. Ky është një hap i rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, rritjes së cilësisë akademike në fushën e mbrojtjes, dhe shkëmbimit të përvojave në arsimin dhe trajnimin ushtarak. Për studentët dhe stafin e AFA, kjo përfshirje hap rrugën për zhvillim profesional dhe integrim në standardet më të avancuara evropiane të sigurisë dhe mbrojtjes.

★★★★★



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MBROJTJES

## VIZITË E ATASHEVE USHTARAKË NË FT

Delegacioni i atasheve ushtarakë rezidentë dhe jorezidentë në vendin tonë zhvilluan një vizitë përnjohëse në Batalionin e Këmbësorisë së Lehtë, ku u njohën nga afër me strukturën, misionin dhe kapacitetet operationale të kësaj njësie. Delegacioni, me përfaqësues nga Polonia, Bullgaria, Gjermania, Italia, Greqia, Turqia dhe Çekia, si dhe atasheun ushtarak të BE-së jorezident, u pritën nga drejtuesit e batalionit dhe përfaqësues të FT.

★★★★★



# MBYLLEN DY STËRVITJE TË KONTIGJENTIT TË XVIII EOD

Efektivët e Kontingjentit të XVIII EOD, të atashuar pranë Brigadës Shumëkombëshe Kanadeze, kanë realizuar stërvitjet “Night Sapper” dhe “Lethal Sapper”, në bashkëpunim dhe koordinim me struktura të tjera xheniere të vendeve anëtare të NATO-s. Gjatë këtyre stërvitjeve, Toga EOD realizoi skenarë të shumtë, duke demonstruar aftësi teknike dhe taktike për asgjësimin dhe vendosjen në siguri të municioneve të paplasura.

★★★★★



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MBROJTJES



# STËRVITJA “MBUROJA ALBANE-26”

Regjimenti i Këmbëtorisë së Jugut zhvilloi në Gjirokastrë stërvitjen kompaktuese në nivel batalioni, “Mburoja Albane-26”. Qëllimi kryesor i kësaj stërvitjeje ishte testimi dhe rritja e gatishmërisë operationale në funksion të përmbushjes së misionit, detyrave kombëtare dhe angazhimeve ndërkombëtare në kuadër të NATO-s.

